


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 608 Akti
Data e Regjistrimit 21.03.2024

Nr. 2491/6 Vendimi
Data e Vendimit 05.04.2024

VENDIM

“Për depozitimën e akteve në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse”

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me trup gjykues të
përbërë prej:
GJYQTARE: NERTILA KAPE

Në Tiranë, sot më datë 05.04.2024, ora 13.30, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi
çështjen civile me Nr. 608 akti, datë regj.21.03.2024/data e ardhjes 29.03.2024 që i përket:

KËRKUES: Agim Çiraku, i biri i Seit, i datëlindjes 31.05.1958, banues në
Tiranë, me adresë: Abdyl Frashëri, Nd.8, H.1, Ap.32, Njësia
Administrative Nr.5, Njësia Bashkiake Nr.5, 1019, Tiranë, në
cilësinë e Presidentit të Federatës Shqiptare të Notit.

OBJEKTI: Depozitimën në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të
vendimeve të Asamblesë së Përgjithëshme datë 28.02.2024 të
Federatës Shqiptare të Notit dhe procesverbalit të mbledhjes.

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë; Ligji Nr.8788, datë
07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligji
Nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave
Jofitimprurëse”, i ndryshuar.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi administroi aktet
shkresore, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

I. Rrethanat e faktit

Kërkuesi i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën për depozitimin e vendimeve dhe procesverbalit të Mbledhjes së Përgjithëshme të Asamblesë së Federatës Shqiptare të Notit të datës 28.02.2024.

Në përputhje me parashikimin e Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar, gjykata vendosi të shqyrtojë kërkesën në dhomë këshillimi.

Po ashtu, në kuadër të një hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm, gjykata urdhëroi tërheqjen e praktikës së regjistrimit të Shoqatës "Federata Shqiptare e Notit" nga Regjistri i OJF-ve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

II. Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata nisur nga përmbajtja e kërkesës, aktet e depozituara bashkëlidhur saj si dhe administrimi i praktikës të mëparshme të gjykatës lidhur me shoqatën "Federata Shqiptare e Notit", konstaton se, plotësohen kërkesat e parashikuara në ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar dhe atë Nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar, për pranimin e kërkesës për depozitimin e procesverbaleve dhe vendimeve të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme të anëtarëve të Federatës datë 28.02.2024.

Gjykata arrin në këtë konkluzion pasi:

Nëpërmjet procesverbalit nr.1, datë 28.02.2024, pasqyrohet vendimi i marrë nga Asambleja e Përgjithëshme e shoqatës "Federata Shqiptare e Notit" duke vendosur: "1. Pranimin e anëtarëve të rinj të federatës si më poshtë:

-Shoqëria "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a", me Nipt: M23706601A; - Shoqata "SKAMPIS", regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.5825, datë 15.03.2018; - Shoqata "SHKODRA NOT", regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendim Nr.6675, datë 26.04.2021; - Qendra "VALA SWIMMING TEAM", regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendim Nr.1380, datë 15.04.2019", të cilët pranohen në Federatën Shqiptare të Notit si anëtare me të drejta të plota; 2. Miratimin e vendimit të KD për refuzimin e Shoqatës "FUTURE SPORT ACADEMY SHKODËR 2022", si anëtare me të drejta të plota për mospërbushje të kushteve; 3. Miratimin e Kalendarit Sportiv 2024; 4. Miratimin e buxhetit 2024 në shumën 8,900.000 Lekë; 5. Regjistrimin e Vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.". Ky vendim rezulton të jetë nënshkruar nga z. Keis Fetishaj, znj. Luljeta Ndoja dhe z. Jurgen Fici, në cilësinë e anëtarit të Komisionit.

Po ashtu nëpërmjet procesverbalit nr.2, datë 28.02.2024 rezulton që Asambleja e Shoqatës të ketë vendosur: "1. Miratimin e ndryshimeve statutore si më poshtë: në nenin 7 të statutit pika 3-Komisionet, shtohet parashikimi: G)Komisioni Sportistëve; në nenin 12 të statutit- ZGJEDHJET- në pikën 7 shtohet: g) Moshë e presidentit që do të kandidojë të jetë deri në 75 vjeç; në nenin 13

të statutit- Këshilli Drejtues, pika 2, ndryshohet sipas parashikimit: - Ai përbëhet nga 5 anëtarë, ku 30% të jenë femra, me këtë strukturë: presidenti dhe 4 antërae. 2. Regjistrimi i vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Ky vendim rezulton të jetë nënshkruar nga z. Keis Fetishaj, znj. Luljeta Ndoja dhe z. Jurgen Fici, në cilësinë e anëtarit të Komisionit.

Nga aktet shkresore të administruara rezulton se shoqata “Federata Shqiptare e Notit” është regjistruar si person juridik bazuar në vendimin nr.249 datë 20.05.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke përcaktuar organet e saj. Ndërkohë me ndryshimin e statutit, miratuar me vendimin e Gjykatës, organet e shoqatës janë: Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve; Komiteti Drejtues, Sekretariati i përgjithshëm si dhe Komisionet.

Referuar Statutit të Shoqatës “Fedrata Shqiptare e Notit”, një nga kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme është miratimi i Statutit ose ndryshimet e tij si dhe pranimi, pushimi, pezullimi apo dorëheqja e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut. Ndërsa sipas nenit 10 të këtij Statuti vendimet merren me nëse janë prezent më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1%) që kanë të drejtë të votojnë, me votën e shumicës.

Në rastin konkret rezulton se me Vendimin e pasqyruar në procesverbalin nr.1, datë 28.02.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës “Federata Shqiptare e Notit”, është vendosur: “1. Pranimin e anëtarëve të rinj të federatës si më poshtë:

Shoqëria “Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a” me Nipt: M23706601A; - Shoqata “SKAMPIS”, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.5825, datë 15.03.2018; - Shoqata “SHKODRA NOT”, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendim Nr.6675, datë 26.04.2021; - Qendra “VALA SWIMMING TEAM”, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendim Nr.1380, datë 15.04.2019”, të cilët pranohen në Federatën Shqiptare të Notit si anëtare me të drejta të plota; 2. Miratimin e vendimit të KD për refuzimin e Shoqatës “FUTURE SPORT ACADEMY SHKODËR 2022”, si anëtare me të drejta të plota për mospërbushje të kishteve; 3. Miratimin e Kalendarit Sportiv 2024; 4. Miratimin e buxhetit 2024 në shumën 8,900.000 Lekë; 5. Regjistrimin e Vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. ”. Ky vendim rezulton të jetë nënshkruar nga z. Keis Fetishaj, znj. Luljeta Ndoja dhe z. Jurgen Fici, në cilësinë e anëtarit të Komisionit.

Po ashtu nëpërmjet procesverbalit nr.2, datë 28.02.2024 rezulton që Asambleja e Shoqatës të ketë vendosur: “1. Miratimin e ndryshimeve statutoe si më poshtë: në nenin 7 të statutit pika 3- Komisionet, shtohet parashikimi: G)Komisioni Sportistëve; në nenin 12 të statutit-ZGJEDHJET- në pikën 7 shtohet: g) Moshë e presidentit që do të kandidojë të jetë deri në 75 vjeç; në nenin 13 të statutit- Këshilli Drejtues, pika 2, ndryshohet sipas parashikimit: - Ai përbëhet nga 5 anëtarë, ku 30% të jenë femra, me këtë strukturë: presidenti dhe 4 antërae. 2. Regjistrimi i vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Në këto kushte, bazuar në praktikën e administruar, në ligjin Nr.8788 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe Nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i ndryshuar si dhe Statutin e Shoqatës, gjykata konstaton se kërkesa e paraqitur për depozitimin e vendimit/procesverbalit nr.1, datë 28.02.2024 dhe vendimit/procesverbalit

nr.2, datë 28.02.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqatës “Federata Shqiptare e Notit”, është e bazuar e si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimn në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të vendimit/procesverbalit nr.1, datë 28.02.2024 dhe vendimit/procesverbalit nr.2, datë 128.02.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës “Federata Shqiptare e Notit”.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
4. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të OJF-ve për kryerjen e veprimeve përkatëse.

Tiranë, më 05.04.2024

SHPENZIME GJYQËSORE

Taksë kërkesë 1000 Lekë

Shpenzime njoftimi 150 Lekë

TOTALI 1150 Lekë

